



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

MENDIM NË PAKICE

Mbi votimin “KUNDËR” ndaj qëndrimit të shumicës për pikën 2 të Vendimit nr. 32, datë 23.01.2020, në përgjigje të kërkesës drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga znj. {...}, në lidhje me njohjen e të drejtës për tu zgjedhur në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë që kanë një pozicion të lirë të përhershëm.

Në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **datë 23.01.2020** në pikën e tretë të rendit të ditës, është përfshirë për shqyrtim në këtë mbledhje projektvendimi “Për kërkesën e znj. {...} për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”.

Për sa më sipër, nisur nga fakti që kemi mbajtur qëndrim të kundërt me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe bazuar në *nenin 66 pikën 9, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit Të Drejtësisë” ..omissis.. Në rastet kur Këshilli merr vendime administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, anëtari i mbetur në pakicë mund të kërkojë që opinioni i tij t’i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, anëtari është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e opinionit të pakicës brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit...”, parashtrojmë sa më poshtë argumentet tona, në lidhje me këtë çështje.*

Me Vendimin nr.32, datë 23.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor shumica e anëtare ka vendosur :

1.Të refuzojë kërkesën e magjistrates {...} për dhënie pëlqimi për komandimin e saj si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

2.Të njohë të drejtën e znj.{...} për të zgjedhur në një nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë që kanë një pozicion të lirë të përhershëm.

Neni 138 dhe 145/1 të Kushtetutës si edhe ndër të tjera edhe neni 57 pika 4 e Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” garanton dhe sanksionon pavarësinë e jashtme dhe e brendshme e pushteti gjyqësor, (pavarësia nga pushtetet e tjera dhe pavarësia gjyqësore individuale pasi gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve shih vendimin nr.40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

Në lidhje me pavarësinë individuale ajo sigurohet ndër të tjera edhe me procedurave të emërimit, të promovimit të gjyqtarëve bazuar mbi kualifikimin profesional dhe integritetit personal si edhe të detyrimit të ruajtjes së pozicionit të punës gjatë kohës që ata janë në periudhën e komandimit. Kjo

procedurë promovimi rregullohet në mënyrë të detajuar nga neni 43, 47 dhe 57 e tjerë të Ligjit për Statusit.

Kuptimi dhe rëndësia e sistemit të garancive që lidhen me statusin e gjyqtarit është analizuar edhe më parë nga jurisprudenca kushtetuese duke theksuar në këtë rast rëndësinë që ka ky sistem në kuadër të pavarësisë së gjyqtarit. Garancitë e sanksionuara nga dispozitat Kushtetuese u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në page por edhe në qëndrueshmërinë apo ruajtjen e pozicionit të funksionit apo elemente të tjera që burojnë nga ushtrimi i saj.

Statusi i gjyqtarëve dhe garancitë që ato ofrojnë synojnë sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë së tyre, elemente këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve.

Në kuadër të analizës së mësipërme **Pakica** vlerëson aktet e administruara. Nga këto akte rezulton se me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.3983, datë 21.10.2003 është përcaktuar se *“...omissis. studentet e Shkollës së Magjistraturës që kanë përfunduar vitin e dytë, emërohen gjyqtar dhe do të kryejnë stazhin profesional në Gjykatat e Shkallës së Parë sipas ndarjes së mëposhtme: në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, caktohen: ...{...} ...”*

Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë {...} znj. {...} është caktuar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Me Vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. {...}, datë {...} znj. {...} është emëruar inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërkohë që në këtë gjykatë me Dekretin nr. {...}, datë {...}, “Për caktimin e numrit të gjyqtareve, për çdo Gjykatë të Shkallës së Parë”, numri i gjyqtareve është përcaktuar në 7 (shtatë).

Me Dekretin nr. {...}, date {...}, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo Gjykatë të Shkallës së Parë, të Apelit dhe të Gjykatave Administrative, si edhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të Gjykatave Administrative” numri i gjyqtareve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë është reduktuar në 4 (katër). Në momentin e daljes së këtij Dekreti, por dhe aktualisht, në këtë gjykatë kanë emërimin e përhershëm (janë caktuar në mënyrë të përhershme në kuptim të ligjit aktual në fuqi, Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”), znj. {...}, z. {...}, z. {...}, i komanduar aktualisht si ndihmës ligjor/ndihmës magjistrat në Gjykatën e Lartë dhe z. {...}, i pezulluar me vendimin nr. {...}, datë {...} të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Me Vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. {...}, date {...}, “Për dhënien e pëlqimit znj. {...}, për të shërbyer si {...}, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur “ Të japë pëlqimin që inspektore {...}, të shërbejë si {...} në Ministrinë e Drejtësisë, duke e konsideruar të mbaruar mandatin e saj si inspektore pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë...omissis

Ashtu si shumica ndaj të njëjtën opinion se përfundimisht, zj.{...}, me mbarimin edhe të afatit 5 vjeçar të komandimit të dytë (për shkak të Ligjit nr.

96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”), për efekt të zhvillimit të karrierës si magjistrat, ka detyrimin të shërbejë si magjistrat **në pozicion gjyqtari atje ku ajo është dekretuar, emëruar në mënyrë të përhershme, sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. {...}, datë {...}, pra në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.** Ky akt përfaqëson detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, por edhe të magistrates {...}, pasi konform nenit 57, pika 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktuar se **“Magjistrati ka të drejtë që pas periudhës të komandimit të kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në ligj”.**

Për shkak të përfshirjes më vonese në rendin e ditës të diskutimit të kërkesës së znj.{...}, nga ana e Kryetares, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në datë 09.01.2020 me Vendimin nr.17, ka deklaruar mbarimin e statusit të z. {...} gjyqtar pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Kavajë duke krijuar në këtë mënyrë lirim të përhershëm të pozicionit të gjyqtarit në këtë gjykatë. Në këto kushte Këshilli kishte detyrimin e caktimit të magistrates kërkuese pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për të ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë së cilës ajo ishte emëruar. Ky detyrim përfshihet jo vetëm në rastin e komandimit të magistratit por edhe në rastin e caktimit të përkohshëm konform nenit 60 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” së cilës i është referuar edhe shumica gjatë arsyetimit të aktit. Ky përbën detyrimin e vetëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për këtë shkak çmoj se vendimin i shumicës është në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ***Caktimi i saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë vjen në kundërshtim edhe me parime të rëndësishme që rregullojnë statusin e magistratit dhe konkretisht nenin 42 dhe 43 të Ligjit nr.96/2016 duke krijuar diskriminim*** tek magistratët të cilët për shkak se kanë ushtruar prej shumë kohësh funksionin në Gjykata të tjera do të kërkonin të përfitonin nga procedura e lëvizjes paralele duke konkurruar, *par condicio*, për pozicionet e lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Për sa më sipër, shprehim qëndrimin dhe argumentet tona dhe votuam **“KUNDËR”** propozimit njohjen e të drejtës për tu zgjedhur në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë që kanë një pozicion të lirë të përhershëm për refuzimin e kërkesës së, për kthim në funksionin e gjyqtarit.

Anëtar
Alban Toro

Anëtare
Marçela Shehu

Anëtare
Brunilda Kadi